



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:059685

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06231006

KF.nr.96/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Debora” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810002767 dhe me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Shoqëria e Avokatëve “Legus” Sh.P.K në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlerë e kontestit 13,007.98 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Naim Spahiu avokat nga Shoqëria e Avokatëve “Legus” Sh.P.K dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditurit Albërije Hoxha Dedushaj, me datë 20.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Debora” Sh.P.K, me seli në Fushë Kosovë, si e pabazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/2980 i datës 10.03.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 01.06.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër Doganës së Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale sepse nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore (neni 16 pika 1.1 i LKA), për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, sepse

është konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendja faktike (neni 16 pika 1.3 i LKA) dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtë materiale. Me propozim që të aprovohet kërkesëpadia, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/2980 G.R i datës 10.03.2020, dhe të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurë gjyqësore.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 09.03.2021 ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Me aktvendimin e kontestuar nr.01.3.2.2/2980 datë 10.03.2020 të Doganës së Kosovës është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar. Aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal, me Aktgjykimin A.nr.911/2020, të datës 08.06.2022, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që ka anuluar aktvendimin nr.01.3.2.2/298 të datës 10.03.2020 të nxjerr nga e paditura dhe ka obliguar të paditurën që paditësit “Debora” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 13,007.98 euro (trembëdhjetë mijë e shtatë euro e nëntëdhjetë e tetë cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimit doganor për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-7256/13.02.2020.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës të njëjtën e ka aprovuar si të bazuar dhe ka prish aktgjykimin A.nr.911/2020, të datës 08.06.2022 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim kësaj Gjykate, përkatësisht Dhomave të Shkallës së parë, Departamentit Fiskal.

Duke vepruar sipas aktgjykimit K.D.SH.II.nr.1557/22, Gjykata në rigjykim, ka caktuar dhe mbajtur seancën gjyqësore në të cilën ka aprovuar propozimin për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare dhe me aktvendimin nr. KF.nr.96/24 të datës 03.05.2024 ka caktuar ekspertin financiar me detyra si në dispozitiv të të njëjtit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndrojnë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe deklarimeve në seancat e kaluara. Konfirmojnë

pranimin e ekspertizës financiare të punuar nga eksperti i caktuar nga kjo gjykatë. Ka shtuar se ndaj ekspertizës nuk kanë vërejtje pasi që e njëjta është punuar në mënyrë profesionale dhe ka vënë në pah pretendimet tona. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara vërtetohet se vendimi kontestues është marrë në kundërshtim të KDAK-së duke i propozuar gjykatës të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi, të anulohet vendimi kontestues si dhe ti kthehet shuma 13,007.98 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë e deri në kthimin e saj. Me prova të qarta është vërtetuar se baza e kërkesëpadisë është në bazë të çmimit real të paguar gjë të cilën ekspertiza financiare e ka vërtetuar. Me rritjen e bërë nga ana e doganës me rastin e vendimit kontestues në kundërshtim me KDAK vërtetohet se paditësi ka paraqitur çmimin real dhe se ndryshimet në mes të pro faturës dhe faturës së deklaruar është formë e lirimit të kontraktimit në marrëdhëniet juridike komerciale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe duke i propozuar gjykatës që të refuzoj si të pabazë pasi që bazuar në shkresat e lëndës paditësi pranë të paditurës si dhe nga shkresat e lëndës në padi nuk ka arritur të dëshmojë vlerën e transaksionit sipas nenit 33 të KDA-së pasi që ka mos përputhej në mes të pro faturave, faturave dhe pagesës bankare. Gjithashtu paditësi nuk ka deklaruar apo prezantuar edhe deklaratën eksportuese të shtetit eksportues ku do të dëshmohej vlera dalëse e mallit eksportues. Po ashtu ka kundërshtuar ekspertizën financiare pasi që e njëjta nuk ka arritur të dëshmojë vlerën reale të transaksionit duke u mbështetur në prova materiale pasi që faqen e pestë par.1 kemi një mos përputhje në vlerë prej 1,173.50 dollarë ku është arsyetuar kinse paditësi ka përfituar zbritje në vlerën e ndryshimit në mes të pro faturës dhe faturës. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave kësaj ekspertize financiare të mos ia fal besimin. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas analizimit të fjalës përfundimtare të përfaqësuesit të paditësit në seancën e datës 08.06.2022 si dhe deklarimeve në këtë seancë rreth diferencës së këtyre mjeteve lehtë mund të vie në përfundim se kemi kontradikta pasi që në deklarin e seancës të datës 08.06.2022 ndër të tjera ka cekur: lidhur me dallimin në mes të shumë së pagesës dhe vlerës së mallit të paguar me DUD dhe faturë arsyeja është ajo që eksportuesi i mallit me rastin e dërgesës së mallit ka dërguar një sasi më të vogël të mallit nga malli i shënuar në pro faturë prej 40,703.50 euro, ndërsa me faturë është 39,503.00 euro. Ndërsa deklarimi në këtë seancë edhe i ekspertit arsyetohet diferenca e këtyre mjeteve kinse paditësi nga data e porosisë së mallit deri te faturimi ka përfituar zbritje në vlerën e ndryshimit në mes të pro faturës dhe faturës.

Gjykatës i kanë propozuar që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe pa mbështetje materiale duke e lënë në fuqi aktvendimin e atakuar me padi si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 20.09.2024, ka administruar provat dhe atë: Procesverbali i përpiluar për lëndën A.nr.911/20 i datës 08.06.2022 dhe Ekspertiza financiare së bashku me shtojcën e datës 14.06.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata nga DUD-i kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar mallin për zhdoganim në ZBD Prishtinë në bazë të gjendjes faturale dhe dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, me ç' rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-it kontestues, Dogana e Kosovës konstaton se malli lëndor është rivlerësuar në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit në pajtim me nenin 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme dhe në këtë rast subjekti në procedurë-paditësit i është ngritur baza doganore, dhe është detyruar që të paguaj taksë doganore më të lartë se të deklaruar me faturën e mallit.

Me vendimin nr.01.3.2.2/2980 e datës 10.03.2020, e paditura Dogana e Kosovës ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi rivlerësimin e Sektorit Qendror, e ndaj të cilit paditësi ka parashtruar këtë padi në Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.911/2020 të datës 08.06.2022, është aprovuar padia e paditësit si e bazuar, është anuluar vendimi nr.01.3.2.2/2980 i datës 10.03.2020, dhe është obliguar Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit "Debora" Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë t' ia kthej shumën prej 13,007.98 euro (trembëdhjetë mijë e shtatë euro e nëntëdhjetë e tetë cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore për shkak të

rivlerësimi të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr.R-7256/13.02.2020 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, me kamatë ligjore 8 %.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.911/2020 të datës 08.06.2022, e paditura Dogana e Kosovës ka paraqitur ankesë. Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.911/2020 të datës 08.06.2022 e ka prishur dhe lëndën e ka kthyer pran Gjykatës së Shkallës së Parë, në rigjykim dhe rivendosje.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganore dhe të Akcizave të Kosovës. Tutja ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit për emërtimin e parë është bazuar në metodën e gjashtë (6) të vlerësimit neni 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, derisa caktimi i vlerës së mallit bazuar në të dhënat e disponueshme që paraqet një të dhënë të besueshme, gjithmonë duke pas parasysh që Sektori i Vlerës në vazhdimësi ka përcjell ndryshimet e çmimit për mallin lëndor kontestues, andaj në bazë të këtyre ndryshimeve, përkatësisht karakteristikave të ngjashme të mallit, kanë përcaktuar çmimin për mallin lëndor, derisa caktimi i vlerës së mallit bazuar edhe në zhdoganimet e mëhershme të mallrave të ngjashme që kanë karakteristika të ngjashme me mallin kontestues por që kanë vlerë më të lartë të transaksionit, që në rastin konkret Dogana e Kosovës i merr si të dhëna të disponueshme.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.96/24 të datës 03.05.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar E.U. i cili ka pasur për detyrë analizimin e transaksionit bankar-pagesën e bërë për mallin e deklaruar në DUD-in kontestues, analizimin dhe krahasimin edhe me subjektet të tjera nëse malli në

periudhën kontestuese e kishte çmimin e deklaruar pran të paditurës, të analizon dhe konstaton të dhënat e të paditurës në lidhje me vlerësimin e mallit gas në këtë periudhë sa ishte çmimi.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 14.06.2024, është dhënë mendimi profesional ku i njëjti ka konstatuar se: *“Sipas dokumenteve paditësi ka kryer pagesën e plot tek furnitori duke u barazuar plotësisht me pro faturën e cila është bashkangjitur lëndës, vlera e pagesës nuk barazohet me vlerën e faturës e cila nga paditësi është arsyetuar që nga data e porosisë deri tek faturimi, çmimi është ndryshuar dhe paditësi në këtë rast ka përfituar zbritje në vlerën e ndryshimit përmes pro faturës dhe faturës (USD) \$ 1,173.5. Çmimet e furnizimit pas ekspertimit para transportit dhe obligimeve doganore me rastin e prezantimit në doganë më 13.02.2020 janë: Gaz-Refrigeant R134a-38.8 USD apo 35.12 euro, Gaz-Refrigeant R404a-30.8 USD apo 27.88 euro, Gaz-Refrigeant R410a-28 USD apo 25.34 euro, Gaz-Refrigeant R40a-28 USD apo 25.34 euro, Gaz-Refrigeant R407a-31 USD apo 28.06 euro”.*

Në seancën në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 20.09.2024 eksperti financiar E.U. ka deklaruar se: *“Mbes pranë ekspertizës financiare të dorëzuar me datë 14.06.2024 konform detyrave të dhëna kam paraqitur konstatimin. Po ashtu siç edhe e kam cekur në ekspertizë lidhur me detyrën e dytë nuk kam arritur të paraqes një konstatim të plotë meqenëse siç është cekur në ekspertizë kjo ka ndodhur si rezultat i mos komunikimit të këtu palës së paditur respektivisht mos ofrimi i dokumenteve të ofruara. Jam i gatshëm të ofroj sqarime shtesë”.* Eksperti në seancë pas ballafaqimit me pyetje edhe ate te konstatimi lidhur me detyrën e parë keni theksuar çmimi është ndryshuar dhe paditësi në këtë rast ka përfituar zbritje në vlerën prej 1,173.5 dollarë, si është vërtetur fakti se pala ka përfituar zbritje, i njëjti ka deklaruar se *“në rastin e caktuar bashkangjitur lëndës kanë qenë edhe disa email-a kryesisht në gjuhën angleze dhe unë duke dashur që të sigurojë provën shtesë kam pasur takim me pronarin e paditësit në objektin e tyre dhe i njëjti zbritjen më ka konfirmuar vetëm verbalisht”,* do të thotë se konstatimi i zbritjes mbështetet vetëm në pohimin e paditësit por jo ndonjë provë materiale, deklarimi i tij ka qenë *“nuk kam pasur prova tjera”.*

Gjykata ekspertizës financiare të datës 14.06.2024, nuk i'a ka falur besimin e plotë, kjo për faktin se mendimi dhe konstatimi i dhënë në ekspertizë dhe sqarimet e paraqitura nga eksperti financiar në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 20.09.2024, janë në kontradiktë njëra me tjetrën.

Gjykata i vlerësoj të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, deklarimit të ekspertit financiar në shqyrtimin gjyqësor publikë të datës 20.09.2024 si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata pretendimin e paditësit se ka paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara me Kodin Doganor dhe të Akcizave si dhe UA.nr.06/2015, e vlerëson si të pa bazuar për faktin se në rastin konkret vlera e mallit në DUD-in e kontestuar është deklaruar në vlerë prej 39,530.00 USD, sipas faturës së mallit të lëshuar pas pagesës së mallit me nr.BekA19010 të datës 26.12.2019, nga shitësi i mallit i cili siç shihet për dallim nga çmimi i katër emërtimeve të mallit të shënuar në pro faturë, në faturë ka shënuar më lirë në vlerë prej 1,173.50 euro, për dalim nga vlera e mallit në pro faturë. Pretendimi i paditësit se ka përfituar zbritje në vlerën e ndryshimit mes pro faturë dhe faturës edhe ate (USD) \$1.173.5, ky pretendimi është i pa bazuar sepse paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshëm për të vërtetuar këtë pretendim. Këtë konstatim Gjykata e mbështet po ashtu edhe në deklarimin e ekspertit financiar E.U. në seancën e datë 20.09.2024 ku ka theksuar se *“në rastin e caktuar bashkangjitur lëndës kanë qenë edhe disa e-maila kryesisht në gjuhën angleze dhe unë duke dashur që të sigurojë provën shtesë kam pasur takim me pronarin e paditësit në objektin e tyre dhe i njëjti zbritjen më ka konfirmuar vetëm verbalisht”*, do të thotë se konstatimi i zbritjes mbështetet vetëm në pohimin e paditësit por jo ndonjë provë materiale, andaj Gjykata nuk i ka dhënë besimin pretendimeve të paditësit.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën i'a ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës dokumentacion për të provuar se vlera e deklaruar është vlera e paguar për mallin lëndor, mirëpo gjykata vlerëson së dokumentet e paraqitura nuk paraqesin vlerën e vërtet të transaksionit të paguar nga paditësi. Pra, si të tilla edhe nuk mund të pranohen dhe nga

gjykata, andaj edhe nuk mund të aplikohet neni 33 par. 1 të KDA-së. Prandaj, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit për emërtimin e parë është bazuar në metodën e gjashtë (6) të vlerësimit neni 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme që paraqet një të dhënë të besueshme.

Tutje Gjykata vlerëson se nuk kemi as shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga e paditura, e që lidhen me mos verifikimin e provave në të cilat mbështeten aktvendimet kontestuese, pasi që nga ekzaminimi i aktvendimeve kontestues shihet qartë se e paditura në procedurë të ankesës, ka administruar si provë të gjithë dokumentacionin përcjellës të mallit mirëpo e njëjta me të drejtë nuk i ka vlerësuar si të mjaftueshme sepse vlera e mallit në DUD-in kontestues nuk paraqet vlerën e vërtet të transaksionit të paguar nga paditësit.

Në vijim Gjykata, lidhur me gjendjen faktike ka elaboruar edhe nenin 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.*

Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag. 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.96/24 datë 20.09.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomës së shkallës së parë të kësaj Gjykate.